

# AKT THEMELIMI 1 SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "BUSINESS & FINANCE 2024 " SHPK

## Neni 1: Emri dhe forma ligjore

Sot me date 16.01.2024, bazuar ne legjislacionin shqiptar dhe kryesisht në ligjin nr. 7850 date 29. 7.1994 "Per Kodi Civil i Republikës se Shqipërisë" ndryshuar, ligjin nr. 9901 da të 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, dhe në ligjin n r. 131/2015 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit" une , i nënshkruari:

1. Salvatore Squillante , shtetas italian, lindur ne Itali, i datëlindjes 08.11.1947, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, me numër identifikimi pasaporte italiane YA8367238

themelon një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin: " **BUSINESS & FINANCE 2024** " SHPK

Shoqëria rregullon veprimtarine e saj ne perputhje me Aktin e Themelimit, Statutin e saj, me ligjin 9901 date 14.04.2008 "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

## Neni 2: Selia

Selia e shoqërisë do të jetë:

Lagjia 13, Rruga Martin Camaj, Zona kadastrale nr 1031, nr pasurie 35/142, Durres. Shoqëria mund të hapë filiale, degë apo përfaqësi në të gjithë territorin shqiptar dhe jashte vendit.

## Neni 3: Objekti

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj si vijon:

- 
- Veprimtari te shitblerjes se pronave te patundeshme. Blerja dhe shitja e pasurive të paluajtshme në pronësi të vet; Dhënia me qira dhe funksionimi i pasurive të paluajtshme të veta ose të marra me qira; Blerja dhe shitja e pasurive të paluajtshme në pronësi të vet; Dhënia me qira dhe funksionimi i pasurive të paluajtshme të veta ose të marra me qira;
  - Aktivitete financiare
  - Shoqëriatregtare mund të ushtrojë çdo veprimtari, e cila nuk ndalohet me ligj bazuar në nenin 7 të ligjin nr. 9901 datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.
-

#### **Neni 4: Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat.

#### **Neni 5: Kapitali**

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë perbehet nga 1 kuote me vlerë 100.000 Leke  
Kontributi i ortakut do te jete ne para.

#### **Neni 6: Organet drejtuese të shoqërisë**

Organet drejtuese të shoqërisë do të jenë:

- (-) Asambleja e Përgjithshme eshte organi me i larte i vendimarrjes.
- (-) Administrator i shoqërisë do të jetë Salvatore Squillante për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë riemërimi.

#### **Neni 7: Viti ushtrimor**


Viti ushtrimor fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor. Ne vitin e pare te krijimit te shoqerise viti fillon nga data e regjitrimit deri me 31 dhjetor.

#### **Neni 8: Dispozitat e fundit**

Shoqëria respekton ligjin dhe statutin që është pjesë e pandarë e këtij akti. Për çdo gjë tjetër, që nuk është shkruar shprehimisht në këtë statut, zbatohet legjislacioni në fuqi për shoqëritë tregtare, për QKB-në si dhe çdo ligj tjetër mbi veprimtarinë e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar.

Emri dhe nënshkrimi i Ortakeve të Shoqërisë

Salvatore Squillante



Handwritten signature of Salvatore Squillante in blue ink, with the name 'SQUILLANTE Salvatore' written above the signature.